U D H Ë Z I M
Nr. 49, datë 7.6.2001

PËR DETYRAT E POLICICSË SË SHTETIT NË FUSHATËN ZGJEDHORE

Në mbështetje të nenit 18 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Komisioni Qendor i Zgjedhjeve

U D H Ë Z O N:

Me qëllim garantimin e ecurisë normale të procesit zgjedhor, organet e Policisë së Shtetit, në raport me nivelet e ndryshme të komisioneve, kanë këto detyra:

1. Shoqërimin me polic të mjeteve që do të transportojnë fletët e votimit nga magazina e KQZ-së deri në prefekturë dhe çdo KZZ, kundrejt kërkesës dhe planit të lëvizjes së mjeteve të miratuar nga KQZ-ja.

2. Organizimi i ruajtjes së ambienteve të punës së KZZ-ve gjatë periudhës së fushatës zgjedhore deri në dorëzimin në KQZ të tabelave të rezultateve dhe kutive të votimit.

3. Organizimi i ruajtjes së qendrave të votimit, për periudhën nga ora 12.00 e datës 23.6.2001 e në vijim, të vazhdojë deri në përfundimin e votimit, nxjerrjen e rezultateve dhe shoqërimin e përfaqësuesve të KQV-së për dorëzimin e tabelave të rezultateve dhe kutive të votimit në KZZ-në përkatëse.

Për organizimin dhe realizimin e kësaj detyre, çdo KZZ i jep drejtorit të policisë në prefekturë një kopje të vendimit "Për caktimin e vendndodhjes së qendrave te votimit" model 29.

4. Policët e caktuar me shërbim në qendrat e votimit, në mbrëmjen e datës 23.6.2001, të jenë prezent së bashku me anëtarët e KQV-së, në momentin e mbylljes me çelës dhe dyllosjes së derës së qendrës së votimit. Në orën 7.00 të datës 24.6.2001, në prezencë të komisionit, asistojnë në hapjen e qendrës së votimit dhe nga ky moment deri në përfundimin e procesit, të ruajnë objektin në fjalë në distancë deri 100 m.

5. Nëse gjatë procesit të votimit rrezikohet rendi dhe zhvillimi i rregullt i votimit, kur cenohet rendi, kur shfaqen shenja dhune ndaj zgjedhësve ose anëtarëve të komisionit, kur pengohen procedurat e votimit, dhe zgjidhja e konfliktit nuk mund të bëhet me mirëkuptim, KQV-ja vendos pezullimin e votimit dhe kryetari e zëvendëskryetari, ose secili prej tyre, kërkon ndihmën e policisë, duke njoftuar menjëherë edhe KZZ-në përkatëse për incidentin e ndodhur.

Me kërkesën e kryetarit dhe zëvendëskryetarit, ose te secilit prej tyre, policët vihen në shërbim të Komisionit të Qendrës së Votimit, deri në evitimin e parregullsisë së vërejtur. Me rivendosjen e rendit, policëve u kërkohet të largohen nga qendra e votimit për të vazhduar ruajtjen në distancë të saj, ndërkohë që KQV-ja merr masa për vazhdimin e procesit të votimit.

Me rivendosjen e rendit dhe rifillimin e votimit, KQV-ja informon KZZ-në përkatëse dhe punonjësit e policisë e drejtuesit e tyre.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilirian Celibashi